

SYLLABUS: Mikroekonomia I

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Mikroekonomia I
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I-rë, semestri I-rë
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	Sipas orarit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc.Dr.Drita Konxheli-Radoniqi; Ass.Dr.Leke Pula
Detajet kontaktuese:	drita.konxheli@uni-pr.edu ; leke.pula@uni-pr.edu Fakulteti Ekonomik, UP"Hasan Prishtina", Kati i V, Kabineti 69
Përshkrimi i lëndës	Mikroekonomia është pjesë e ekonomisë që studimin e vet e kryen në nivel të individit. Pra, mikroekonomia merret me studimin e sjelljes së agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, firmave të biznesit si dhe të agjensive qeveritare në masën që veprimtaria e tyre lidhet me alokimin e burimeve të kufizuara dhe funksionimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë. Në qendër të vëmendjes së mikroekonomisë janë tregjet e mallrave apo shërbimeve të veçanta dhe kushtet e ekuilibrit të tyre.
Qëllimet e lëndës:	Objektivi i kursit është që në fund të semestrit studentët të kenë një njohuri më të qartë dhe aftësi për të rezonuar lidhur me çështjet ekonomike që kanë të bëjnë me mikro sektorin. Qëllimi i kursit është që studentët të aftësohen që ngjarjet jashtë modeleve ekonomike t'i interpretojnë në kuadër të botës reale, si dhe ngjarjet nga bota reale t'i interpretojnë brenda një modeli ekonomik duke analizuar dhe kuptuar se çfarë qëndron prapa këtyre ngjarjeve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që të: - tregojnë se si burimet e kufizuara alokohen midis nevojave të pakufizuara - interpretojnë kuptimin e koncepteve ekonomike si pamjaftueshmëria, e mira ekonomike, e mira e lirë dhe faktorët e prodhimit;

	- kuptojnë reagimet e konsumatorit dhe sjelljen e prodhuesve; - përdorin efektin e të ardhurave dhe të zëvendësimit për të analizuar çmimet dhe ndryshimet e tatimeve dhe të ilustrojnë preferencat e konsumatorëve; - kuptojnë në formë kritike se si struktura e tregut influencon vendimet për çmimet dhe prodhimin.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgaditja përfundimtare për provim			25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			1
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Në tri orë ligjërata në javë do të shtjellohet materiali mësimor, do të zhvillohet mësim interaktiv, i ilustruar me prezantime në power point, do të zhvillohen diskutime individuale dhe në grupe, si dhe kohëpaskohe do të organizohen teste të vetëvlerësimit.		
Metodat e vlerësimit:	a. kolokviumi i parë: 25% b. kolokviumi i dytë: 25% c. vijimi i rregulltë: 10% d. provimi final: 50%		

	TOTALI: 100% Kufiri i kalueshmërisë është 51%
Literatura	
Literatura bazë:	Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule dhe Stefan Qirici: Hyrje në Ekonomi, Pegi, Tiranë, 1999;
Literatura shtesë:	Florentina Xhelili Krasniqi: Strukturat e tregut, IFK, Prishtinë, 2018; Ramiz Livoreka: Parimet e mikroekonomisë, Prishtinë, 2012; W.Boyes & M.Melvin: Microeconomics, Seventh Edition, Houghton Mifflin Company, Boston New York, 2008;
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i Syllabus-it
Java e dytë:	Një vështrim i përgjithshëm mbi Shk.Ekonomike
Java e tretë:	Kërkesa, Oferta, Ekuilibri i tregut
Java e katërt:	Elasticiteti i Kërkesës dhe i Ofertës
Java e pestë:	Sjellja Konsumatore
Java e gjashtë:	Firmat
Java e shtatë:	Kolokviumi 1
Java e tetë:	Teoria e Prodhimit dhe e Produktit Marxhinal
Java e nëntë:	Kostoja
Java e dhjetë:	Konkurrenca e Plotë
Java e njëmbëdhjetë:	Monopoli
Java e dymbëdhjetë:	Konkurrenca Monopolistike dhe Oligopoli
Java e trembëdhjetë:	Kolokviumi 2
Java e katërbëdhjetë:	Shpërndarja e të Ardhurave
Java e pesëmbëdhjetë:	Sektori Publik

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
• Studentët duhet të respektojnë orarin e mësimi dhe ardhja në ligjërata është e obligueshme. • Celularët duhet të shkyçen dhe të mos ekspozohen gjatë kohës së ligjëratave. • Nga të gjithë pritjet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në kolokviume dhe në provim